



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është organ njëdhomësh, përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit ligjvënës të Republikës.



Pallati i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë

Kuvendin e përbëjnë 123 deputetë. Prej tyre, 120 deputetë zgjedhen sipas modelit proporcional. Territori i Republikës së Maqedonisë është i ndarë në gjashtë njësi zgjedhore, të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, në të cilat zgjedhen nga 20 deputetë. Tre deputetët tjerë zgjedhen sipas modelit të shumicës në një rreth zgjedhor edhe atë nga një deputet në tri njësi zgjedhore, një në Evropë dhe Afrikë, një në Amerikën Veriore dhe Jugore dhe një në Australinë dhe Azinë, ashtu që qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, të cilët jetojnë ose përkohësisht qëndrojnë jashtë vendit, u jepet mundësi ta realizojnë të drejtën e tyre të votës dhe të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvend. Mandati i deputetëve zgjat katër vjet, pa kufizim të rizgjedhjes.

Zgjedhja e deputetëve në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë mundëson që burimi i legjitimitetit të tyre të jetë vullneti i qytetarëve, dhe paraqet realizim të dispozitës kushtetuese,

sipas së cilës, sovraniteti buron nga qytetarët dhe u takon qytetarëve.

Nocioni “Kuvend” në mënyrë përkatëse e pasqyron esencën e shtëpisë ligjvënëse – vendi ku takohen përfaqësuesit dhe përmes debatit të organizuar miratojnë ligje dhe akte tjera.

KONSTITUIMI I KUVENDIT

Kuvendi konstituohet më së voni 20 ditë pas mbajtjes së zgjedhjeve për deputetë. Seancën konstituive e thërret Kryetari i Kuvendit nga përbërja paraprake. Nëse në këtë afat nuk realizohet mbledhja konstituive, atëherë deputetët takohen vetë dhe e konstituojnë Kuvendin në ditën e njëzetënjëtë pas mbajtjes së zgjedhjeve. Në këtë seancë verifikohet mandati i deputetëve sipas propozimit të Komisionit Verifikues.

Në seancën e njëjtë, Kuvendi nga radha e deputetëve e zgjedh Kryetarin e Kuvendit.

Me verifikimin e mandateve, deputetët fitojnë të drejta dhe detyrime të përcaktuara me kushtetutë, ligj dhe rregullore të punës. Deputetëve iu jepen legjitimacione, ku evidentohet e drejta e imunitetit dhe të drejta tjera, që mund të realizohen në bazë të funksionit të deputetit.

Pas konstituimit, Kuvendi mund t'i ushtrojë funksionet e veta më të rëndësishme, siç janë: funksioni ligjvënës, zgjedhor dhe kontrollues-mbikëqyrës.

KOMPETENCAT E KUVENDIT

Kompetenca themelore e Kuvendit është miratimi i ligjeve me të cilat juridikisht rregullohen marrëdhëniet shoqërore dhe përcaktohen të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e subjekteve shoqërore.

Përveç miratimit të ligjeve, Kuvendi është organi i vetëm, i cili ofron interpretime autentike të ligjeve me të cilat sugjerohet në kuptimin e vërtetë dhe qëllimin e ligjvënës, si dhe jepen udhëzime për implementim konsekuent të tij.

Po ashtu, Kuvendi e miraton dhe e ndryshon aktin më të lartë ligjor, Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, e miraton Buxhetin e Republikës, Llogarinë përfundimtare të Buxhetit, Planin hapësinor të Republikës, ndërsa në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij miraton edhe deklaratata, me të cilat Kuvendi merr qëndrim për çështje që kanë rëndësi të përgjithshme politike; rezoluta, me të cilat sugjerohet për gjendjen, problemet dhe masat, që duhet të ndërmerren në sfera të caktuara; rekomandime, me të cilat jepen udhëzime për tejkalim të gjendjeve aktuale në sfera të caktuara.

Kuvendi ka edhe kompetencë për të marrë vendim për zgjedhjen e anëtarëve të organeve shtetërore dhe për emërim të bartësve të funksioneve publike. Pra, Kuvendi e zgjedh Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, zgjedh gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, e zgjedh Avokatin e popullit, e zgjedh dhe e shkarkon Prokurorin publik të Republikës së Maqedonisë si dhe emëron dhe shkarkon bartësit e funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të përcaktuara me Kushtetutë (kompetencë zgjedhore).

Kushtetuta parasheh edhe instrumente për kontroll të organeve tjera dhe bartësve të funksioneve publike të Kuvendit (pyetje deputetësh, interpelancë, mocion të Qeverisë etj.).

Ngjashëm me këtë Kuvendi ka edhe kompetencë mbikëqyrëse, e cila realizohet përmes debateve mbikëqyrëse, që implementohen nga trupi punues amë, në fushëveprimin e të cilit bën pjesë çështja, që është lëndë interesit. Këto debate zhvillohen, me qëllim që të merren informata dhe mendime profesionale, në lidhje me realizimin e politikave, zbatimin e ligjeve dhe për aktivitete tjera të Qeverisë dhe organeve të administratës shtetërore.

Kuvendi gjithashtu i përcakton detyrimet publike, ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare, merr vendim për luftë dhe paqe, merr vendim për ndryshim të kufirit të Republikës, merr vendim për aderim dhe dalje nga aderimi me aleanca ose bashkësi me shtete tjera, shpall referendum, merr vendim për rezervat e Republikës, themelon këshilla, jep amnisti dhe ushtron punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

MARRËDHËNIA E KUVENDIT ME BARTËSIT TJERË TË PUSHTETIT

Parimi i ndarjes së pushtetit është një ndër vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë. Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, pushteti shtetëror është i ndarë në pushtet ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Në kuadër të ndarjes së pushtetit parashihen mekanizma të caktuara, që sigurojnë “ndikim” të ndërsjellë të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Marrëdhënia e Kuvendit me Qeverinë

Qeveria e Republikës së Maqedonisë është bartëse e pushtetit ekzekutiv. Ajo e përcakton politikën e zbatimit të ligjeve dhe të dispozitave tjera të Kuvendit dhe njëkohësisht është përgjegjëse për realizimin e tyre.

Qeveria është propozuesi më i shpeshtë i ligjeve. Pjesëmarrjen në procesin ligjvënës ajo e realizon përmes mekanizmit të dhënies së mendimit për propozim - ligjet, të cilat nuk i ka propozuar, përmes pjesëmarrjes së përfaqësuesve të saj në punën e Kuvendit dhe në trupat e tij të punës dhe përmes së drejtës për të iniciuar konvokim të seancës plenare të Kuvendit.

Kontrollin e punës së Qeverisë, Kuvendin e bën në tre mënyra: përmes së drejtës për miratim të buxhetit, përmes instrumenteve për ushtrim kontrolli në punën e Qeverisë (pyetje të deputetëve, interpelanca) dhe përmes ngritjes së procedurës për mocion besimi ndaj Qeverisë. Përmes dy instrumenteve të fundit Kuvendi ushtron kontroll politik ndaj punës së Qeverisë si organ ekzekutiv.

Qeveria në punën e vetë duhet të gëzojë besimin e Kuvendit, e përmes tij edhe besimin e shumicës së qytetarëve. Kuvendi mund t'i votojë mosbesimin Qeverisë.

Vendimi për votimin e mosbesimit merret me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Nëse Qeverisë i është votuar mosbesim, ajo e ka për detyrë të paraqesë dorëheqje.

Marrëdhënia e Kuvendit me Presidentin e Republikës

Presidenti i Republikës së Maqedonisë e përfaqëson Republikën. Ai është komandant suprem i forcave të armatosura të Maqedonisë dhe bartës i pushtetit ekzekutiv së bashku me Qeverinë.

Presidenti i Republikës merr pjesë në procesin ligjvënës përmes së drejtës për veto suspenduese të ligjeve, të cilat janë të votuara në Kuvend. Për çdo ligj të miratuar, Presidenti i Republikës duhet të nënshkruajë dekret për shpallje të ligjit (së bashku me Kryetarin e Kuvendit). Presidenti mund të vendos të mos e nënshkruaj dekretin për shpallje të ligjit, nëse konsideron se nuk është në përputhje me Kushtetutën ose është në kundërshtim me marrëveshjet e verifikuara ndërkombëtare. Nëse, Presidenti nuk e nënshkruan dekretin, atëherë ligji kthehet në Kuvend për shqyrtim të sërishëm.

Kuvendi ka të drejtë të ngre procedurë për përgjegjësi të Presidentit të Republikës. Nëse iniciativën e tillë e mbështesin së paku 2/3 e deputetëve, atëherë ajo përcillet në Gjykatën Kushtetuese, që është organi i vetëm kompetent për të marrë vendim për këtë çështje.

Marrëdhënia e Kuvendit me pushtetin gjyqësor

Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat. Gjykatat janë të mëvetëshme dhe të pavarura në punën e tyre. Ligji me të cilin rregullohen llojet, kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave dhe procedura para tyre, miratohet me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve në Kuvend.

Gjithashtu, Kuvendi e përcakton buxhetin gjyqësor dhe zgjedh tre nga pesëmbëdhjetë anëtarëve të Këshillit Gjyqësor.

SI PUNON KUVENDI

Seancat e Kuvendit

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është në punime në përhershme.

Seancat e Kuvendit i thërret Kryetari i Kuvendit. Seancat janë të hapura, por Kuvendi mund të vendos të punojë pa praninë e publikut, për çka nevojiten dy të tretat e shumicës nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Seancat mbahen prej orës 11,00 deri në orën 18,00, me një orë pushim, nëse Kryetari i Kuvendit, për seanca të caktuara nuk vendos ndryshe.

Kryetari i Kuvendit mund të thërrasë seancë edhe me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Qeverisë dhe së paku të 20 deputetëve.

Edhe pse pushimi i Kuvendit zgjat prej 1 deri më 31 gusht, Kryetari i Kuvendit mund të thërrasë seancë edhe në këtë periudhë.

Me seancat e Kuvendit i kryeson Kryetari i Kuvendit. Kuvendi punon në seanca sipas rendit të ditës paraprakisht të miratuar. Në seancën e Kuvendit askush nuk mund të flet para se të kërkojë dhe të merr fjalën nga Kryetari i Kuvendit.

Kuorumi

Kuvendi mund të merr vendime, nëse në seancë marrin pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Kuvendi vendos me shumicë votash të deputetëve të pranishëm në seancë, e së paku me një të tretën nga numri i përgjithshëm i deputetëve, nëse me Kushtetutë nuk parashihet shumicë e veçantë.

Numrin e deputetëve të pranishëm e kumton Kryetari i Kuvendit.

Trupat punues (komisionet)

Për shkak të shqyrtimit të hollësishëm të propozim - ligjeve dhe të çështjeve tjera në kompetencë të Kuvendit, në kuadër të tij formohen trupa të përhershëm dhe të përkohshëm punues, të cilët kontribuojnë për punë më efikase.

Trupat e përhershëm të punës (komisionet) themelohen në fillim të mandatit të Kuvendit dhe funksionojnë gjatë gjithë mandatit, ndërsa komisionet e përkohshme themelohen sipas nevojës. Trupat punues themelohen me vendim të Kuvendit.

Trupat punues konstituohen sipas sferave, ashtu që propozim - ligjet dhe aktet tjera i shqyrton trupi punues amë dhe Komisioni Juridik-Ligjvënës. Për çdo çështje të shqyrtuar, trupi punues amë merr qëndrim dhe dorëzon raport në Kuvend.

Përbërja e trupave punues dhe të komisioneve anketuese përcaktohet varësisht nga numri i deputetëve në kuadër të grupeve parlamentare, i deputetëve të cilët nuk janë të organizuar në grup parlamentar dhe në pajtim me Ligjin për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave.

Trupat punues të Kuvendit kanë kryetar, nënkryetar dhe një numër të caktuar të anëtarëve dhe zëvendësve të tyre.

Trupi punues mund të ketë edhe dy anëtarë të jashtëm – punonjës shkencor ose profesionistë, të cilët marrin pjesë në punën e komisioneve, por pa të drejtë vote.

Po ashtu, trupi punues në mbledhje mund të ftojë punonjës shkencor, profesionistë, përfaqësues të Vetadministrimit lokal, të shoqatave, etj., me qëllim që të shprehën mendime në lidhje me çështjet që shqyrtohen në mbledhjen e trupit punues.

Publiku në punën e Kuvendit

Publiku është parimi themelor i punës së Kuvendit. Seancat e Kuvendit janë publike dhe rrjedha e tyre mund të ndiqet drejtpërsëdrejti në Kanalën e Kuvendit, në kuadër të Radiotelevizionit të Maqedonisë, ose në faqen e internetit të Kuvendit (www.sobranie.mk).

Për punën e Kuvendit raportojnë mjetet për informim publik. Përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të marrin pjesë në Seancat e Kuvendit dhe në mbledhjet e trupave punues, me qëllim që të informojnë publikun për punën e tyre.

Nga ana tjetër qytetarët mund t'i ndjekin seancat e Kuvendit dhe të trupave punues të tij përmes galerive.

Me qëllim që të raportojë për punën e vetë, Kuvendi boton buletinën e vet dhe publikime tjera.

ZGJEDHJA, TË DREJTAT DHE KOMPETENCAT E DEPUTETËVE

Deputetët zgjedhen në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë. Mandati i tyre paraqet funksion publik dhe si i tillë nuk mund të barazohet me ushtrimin e ndonjë funksioni ose profesioni tjetër.

Të drejtën e zgjedhjes për deputet e ka secili qytetar i Republikës së Maqedonisë, i cili ka mbushur 18 vjeç dhe ka kapacitet juridik. Qytetari mund të kandidohet për deputet përmes partisë politike ose përmes grupit të votuesve, nëse grumbullon së paku 1.000 nënshkrime.

Mandati i deputetëve zgjat katër vjet dhe fillon të llogaritet nga mbledhja konstituive e Kuvendit. Mandati mund të vazhdohet vetëm në rast të gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme.

Në Kuvend themelohen grupe të deputetëve, ndërsa deputeti mund të jetë anëtar vetëm i një grupi parlamentar.

Deputeti ka të drejtë dhe detyrim të merr pjesë në seancat e Kuvendit, gjegjësisht në marrjen e vendimeve.

Deputetët gëzojnë imunitet. Deputeti nuk mund të merret në përgjegjësi penale ose të arrestohet për shkak të opinionit të thënë në Kuvend ose për shkak të votimit në Kuvend.

Deputeti merr vendim sipas bindjeve të tij, andaj me asnjë kusht ai nuk mund të revokohet. Ai është përfaqësues i të gjithë qytetarëve dhe merr vendime në emër të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Dita e fundit e javës së punës (e premte) është e paraparë për realizim të kontakteve të deputetëve me qytetarët e njësive të tyre zgjedhore. Kjo është një mundësi, që deputetët t'i dëgjojnë mendimet dhe problemet e qytetarëve dhe të ndërmarrin iniciativa të ndryshme.



Ky dokument është punuar në suazat e Projektit "Vendosja dhe Zhvillimi i Institutit Parlamentar" të Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, i kofinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) me mbështetje këshillëdhënëse të Institutit Nacional Demokratik (NDI). Mendimet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e SDC ose NDI.